

Numri i lëndës: 2021:199107

Datë: 22.03.2024

Numri i dokumentit: 05491009

CP.nr.314/2021

Gjykata Themelore Gjilan dega e V., Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, sipas gjyqtarit Alush Sinani, duke vendosur në çështjen juridike përmbareme të kreditorit V.T., nga fshati P., të cilin e përfaqëson M.H. avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V., Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit ditor, në shumë prej 980.00 euro, gjykata jashtë seancës gjyqësore më datë 22.03.2024 bie këtë:

A K T V E N D I M

I.Përfundohet, procedura përmbareme e kreditorit V.T., nga fshati P., të cilin e përfaqëson M.H. avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V., Drejtoria Komunale për Arsim.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore Gjilan dega e V., kishte lejuar propozimin me nr. CP.nr. 314/2021, të datës 09.09.2021, ndaj kreditorit V.T., nga fshati P., të cilin e përfaqëson M.H. avokate në V., ndaj debitorit Komuna e V., Drejtoria Komunale për Arsim, me bazë juridike kompensimi i pagave jubilarë dhe shpenzimeve të ushqimit ditor, në shumë prej 980.30 euro sipas dokumentit përmbareme akgjykimi C.nr.38/2020 të datës 21.07.2021.

Gjykata, ka pranuar parashtrësën nga ana e të autorizuarit të kreditorit, nga e cila parashtrësë ishte konfirmuar se debitori e ka përmbushur detyrimin në tërësi.

Gjykata pas vlerësimit të parashtrësës konstaton se janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore, që të përfundohet procedura përmbareme ndaj debitorit duke u bazuar në parashtrësën e paraqitur, pranë kësaj Gjykate.

Pasi që gjykata ka konstatuar se debitori e kishte përmbushur detyrimin ndaj kreditorit, gjykata konform nenin 42 parag.2 dhe 66 parag. 4 të LPP-së, ka përfunduar procedurën duke vendosur si në pikën I. të dispozitivit të këtij aktvendimi

Andaj, në bazë të dispozitave të nenit 66 par.4 të LPP-së, dhe duke u bazuar në atë që u tha më lartë u vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS V.
DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM - DIVIZIONI CIVIL**

2021:199107, 22.03.2024

Gj y q t a r i

Alush Sinani

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi mund të ushtrohet ankesë,
Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afatin prej 7 ditësh
nga dita e pranimi të aktvendimit, përmes kësaj gjykate.